



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_310\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_445\_08\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_445\_08\_10**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 02.11.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Nexhmije Kurrumeli (parashtruesi i ankesës Hajdar Kukaj, shifra e konsumatorit DPR - 90038481) nga Drenasi, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 05.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 25.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 32412418 dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 5129548.

**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000442 datë 25.08.2009

- Me datë 25.09.2009 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 32412418, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i mungojnë, nga ana e jashtme njehsori elektrik qelqin e ka të thyer si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror.

**Provë:** Procesverbali me nr. 7/25 i datës 25.09.2009

- Me datë 10.12.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe regjistrimin e pajisjeve të konsumatorit.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 087709 i datës 10.12.2009
- Me datë 18.12.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP08121 në vlerë prej 541.77 €.  
**Provë:** Fatura DPR09HP08121 e datës 18.12.2009
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 30.12.2009
- Me datë 05.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 24.08.2010 DMK në ZRRE pas analizës së lëndës së konsumatorit dhe argumenteve të paraqitura si rrjedhën e energjisë aktive, listat e leximit të KEK-ut, ka lëshuar vendimin ZRRE/DMK\_V\_445\_08\_10 duke pranuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që duke u bazuar në analizat e cekura në vendimin e DMK-së:
  1. Të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimi i paautorizuar të energjisë elektrike (rikthimit të humbjeve) DPR09HP08121 të datës 18.12.2009 në vlerën 541.77 €
- Me datë 02.11.2010 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.  
**Provë:** Apelimi i KEK-ut i datës 02.11.2010

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_445\_08\_10** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar dëshmi shtesë, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut dhe kërkon nga KEK-u që të mbetet në fuqi vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK\_V\_445\_08\_10**.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar